



## N J O F T I M

Shoqëria „**KelKos Energy**“ **Sh.p.k.**, me nr. të biznesit 70551624, me adresë: Rruga „Sali Ceku“ Deçan, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 19 paragrafi 1 dhe Nenin 20 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) kërkesën për MODIFIKIMIN e Autorizimit Final V\_568\_2013 të datës 24 tetor 2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Lumëbardhë, HC Lumëbardhi II. për ndryshimin e kapacitetit instalues nga 5.5 MW në kapacitetin instalues total prej 6.2 MW, që është duke u ndërtuar në ngastrat kadastrave P- 70505021-8-0, P-7430378,606 dhe P – 4716100,239< P-7430402,616, P- 4716110,814, P- 7430401,224, P-4716091,974, P- 7430373,956 dhe P-4716090,390 në Zonën Kadastrale Deçan, Komuna e Deçanit, sipas vendimit nr. 3681-3/18 ZSP /2018 të datës 13.11.2018 mbi ndryshimin e kapacitetit instalues të Hidrocentralit vendimin nr. 1839/11-ZSP-229/13 të datës 19.03.2013 për lëshimin e Lejes Ujore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Arsyet e fillimit të Modifikimit të Autorizimit Final kanë të bëjnë për ndryshimin e kapacitetit instalues dhe ndryshimit të ndërtimit me sistemin kaskad të HC Lumëbardhi II., me N=5.5 MW në N=6.2 MW, bazuar në dokumentacionin si në vijim: Raportin e Reviduar 3 si vlerësim i ndërtimit; Amendamentimin e Dizajnit të ndërtimit të HC Lumëbardhi II dhe Projektit Kaskad Hidrologjik i Lumëbardhit të Deçanit. Projektin përfshinë Kablo të energjisë 35 kW, infrastruktura e Hidrocentralit (planimetria e Tubit), projektin kryesor dhe infrastruktura e gjeneratorit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas vlerësimit të dokumenteve të lartcekura ka lëshuar Vendimin mbi Ndryshimin e Lejes Ujore nr. 3681-3/18 ZSP /2018 të datës 13.11.2018 mbi ndryshimin e kapacitetit instalues të Hidrocentralit nga N=5.5 MW në N=6.2 MW.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.